



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-67359/21 dt. 14.04.2021, të pronareve Naim, Bashkim dhe Milaim Janova, Rrahim dhe Aziz Kongjeli, Safet Ramadani, Milaim, Festim, Hashim Gashi, Imrane Kabashi, Mejreme Hetemi, Ajten Reka nga Prishtina, dhe investitorit ”Pozhegu Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesën “B1”, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “b-05”, të nëntërësisë urbane “B-1”, të tërësisë urbane “B”, të Planit Rregullues “Muhaxherët”, në rr. “Bedri Shala”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 19.10.2021, lëshon këtë:

### CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** Naim, Bashkim dhe Milaim Janova, Rrahim dhe Aziz Kongjeli, Safet Ramadani, Milaim, Festim, Hashim Gashi, Imrane Kabashi, Mejreme Hetemi, Ajten Reka nga Prishtina, dhe investitorit ”Pozhegu Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-67359/21 dt.14.04.2021, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesën “B1” me etazhitet 2B+S+P+11 e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-102321 dhe 05-035-237989 dt. 26.11.2014, në parcelën kadastrale nr. 10094-1, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10094-1, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urbanistik “b-05”, të nëntërësisë urbane “B-1”, të tërësisë urbane “B”, të Planit Rregullues “Muhaxherët” në Prishtinë.

**II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Bedri Shala” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrin: 62, në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njërive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Pronareve Naim, Bashkim dhe Milaim Janova, Rrahim dhe Aziz Kongjeli, Safet Ramadani, Milaim, Festim, Hashim Gashi, Imrane Kabashi, Mejreme Hetemi, Ajten Reka nga Prishtina, me investitor ”Pozhegu Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-67359/21 dt.14.04.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, përkatësisht ndërtesën “B1” me etazhitet 2B+S+P+11 e ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “b-05”, të nëntërësisë urbane “B-1”, të tërësisë urbane “B”, të Planit Rregullues “Muhaxherët” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10094-1, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-102321 dhe 05-035-237989 dt. 26.11.2014, Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të lejes ndërtimore 05 Nr.

shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-198461/20 dt. 07.04.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Krenare Kadriu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Rexhep Saliu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetillës dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Agron Nagavci; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Agim Binaku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Agron Pajaziti; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Arban Shala; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Burim Halilaj me nr. të licensës 195;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetillës dhe kanalizimit, instalimet elektrike, si dhe Raportin e Inspektimit Final konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

**I dorëzohet:** Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZIMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-67359/21 DT. 19.10.2021**

Zyrtari,  
Arbër Morina

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Mimoza Berisha Prestreshi

Drejtori,  
Arifan Olluri

Faqe 2 prej 2

